



Republika e Kosovës
Komuna e Drenasit (Glllogoc)
Kuvendi i Komunës

02 Nr. 170/01-15761 dt. 29/04/ 2025



Bazuar në nenin 11,12 dhe 40 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040, nenit 3, pika 3.5 dhe nenit 34 të Statutit të Komunës së Drenasit, Kuvendi i Komunës së Drenasit (Glllogoc) në mbledhjen e rregullt të mbajtur me datë: 29.04.2025, miratoi këtë:

V E N D I M

Për shpalljen znj. Madeleine Albright, “Qytetare Nderi”, “Post mortum” e Komunës së Drenasit

Neni 1

Me këtë Vendim të Kuvendit të Komunës miratohet shpallja e znj. Madeleine Albright “Qytetare Nderi”, “Post mortum” e Komunës së Drenasit.

Neni 2

Titulli “Qytetare Nderi” për znj. Madeleine Albright “Post mortum” i jepet për kontributin e saj në përkrahje të Kosovës dhe popullit të saj në proceset historike që ka kaluar Kosova.

Neni 3


Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës së Drenasit.

Neni 4

Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë nga dita e regjistrimit dhe vlerësimit të ligjshmërisë nga MAPL-ja, si dhe 7 ditë nga publikimi në Ueb faqen zyrtare të Komunës.



Kryesuesi i Kuvendit të Komunës


Bekim Lestrani

Vendimi i dërgohet:

- Zyrës së Kryetarit
- Zyrës së Kuvendit;
- Arkivit

ARSYETIM

Biografi e shkurtër

Madeleine Jana Korbel Albright, u lind më 15 maj 1937 – ndërroi jetë më 23 mars 2022. Ishte një diplomate dhe shkencëtare politike amerikane që shërbeu si sekretarja e 64-të e shtetit të Shteteve të Bashkuara nën Presidentin Bill Clinton nga 1997 deri më 2001. Ajo ishte grua e parë që mbajti këtë pozitë.

E lindur në Pragë, Çekosllovakia, Albright emigroi në Shtetet e Bashkuara pas grushtit të shtetit komunist të vitit 1948 kur ishte njëmbëdhjetë vjeç. Babai i saj, diplomati Josef Korbel, e vendosi familjen në Denver, Kolorado dhe ajo u bë shtetase e SHBA-së në vitin 1957.

Albright u diplomua në Kolegjin Wellesley në 1959 dhe fitoi një doktoratë nga Universiteti i Kolumbisë në 1975, duke shkruar tezën e saj mbi Pranverën e Pragës. Ajo punoi si ndihmëse e senatorit Edmund Muskie nga viti 1976 deri në 1978, përpara se të shërbente si anëtare e stafit në Këshillin e Sigurisë Kombëtare nën udhëheqjen e Zbigniew Brzezinski. Ajo shërbeu në atë pozicion deri në vitin 1981 kur Presidenti Jimmy Carter la detyrën.

Pas zgjedhjeve presidenciale të vitit 1992, Albright ndihmoi në mbledhjen e Këshillit të Sigurisë Kombëtare të Presidentit Bill Clinton. Ajo u emërua ambasadore e Shteteve të Bashkuara në Kombet e Bashkuara nga viti 1993 deri në vitin 1997, post që e mbajti deri në ngritjen e saj si Sekretare e Shtetit. Sekretarja Albright shërbeu në atë cilësi derisa Presidenti Clinton u largua nga detyra në vitin 2001.


Albright shërbeu si kryetare e Albright Stonebridge Group, një firmë konsulente, dhe ishte profesor i nderuar i Michael dhe Virginia Mortara në praktikën e diplomacisë në Shkollën e Shërbimit të Jashtëm të Universitetit Georgetown.

Ajo u nderua me Medaljen Presidenciale të Lirisë nga Presidenti Barack Obama në maj 2012.

Kur Clinton filloi mandatin e tij të dytë në janar 1997, pas rizgjedhjes së tij, ai kërkoi një Sekretar të ri të Shtetit, pasi presidenti aktual Warren Christopher po dilte në pension.

Gjatë luftës çlirimtare të Kosovës, është e njohur për kontributin e saj për lirinë dhe pavarësinë e Kosovës, me deklaratat, intervistat dhe vendimet si përfaqësuese zyrtare e politikës amerikane ndaj Kosovës.

Në Rambuje, si ndërmjetëse, pati rrol të jashtëzakonshëm për pranimin e kushteve të favorshme për Kosovën të cilat rezultuan me shpalljen e Pavarësisë së Kosovës.



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Për:	Ramiz Lladrovi, Kryetar i Komunës së Glllogocit Milaim Hajdari, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Glllogocit	
Kopje:	Njësia për Administrimin e Dokumenteve në MAPL Njësia për Administrimin e Dokumenteve në Komunë	
Nga:	Jeton Qela, Sekretar i Përgjithshëm në MAPL	Datë: 07.05.2025 VI-020-254
Zyrtarët përgjegjës:	Erbil Hefemi, Drejtor i Departamentit Ligjor	
1. Zyrtari përgjegjës për përcjelljen e aktit në Komunë	Xhevat Tafa, Udhëheqës i Divizionit për Monitorim të Komunave	
2. Zyrtari përgjegjës për hartimin e shkresës përcjellëse	Vjosa Ahmetaj, Zyrtare e lartë për monitorim të komunave	
Lënda:	Shkresë përcjellëse	
Lloji i aktit:	Vendim i Kuvendit të Komunës	

I nderuar Kryetar,
I nderuar Kryesues,

Bazuar në Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 06/2021 për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores (QRK) Nr. 10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, (shtojca II - Aktet e organeve të komunës që nuk i nënshtrohen shqyrtimit të detyrueshëm apo të rregullt të ligjshmërisë), Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal pas shqyrtimit të përmbajtjes së akteve të Kuvendit të Komunës së Glllogocit, vlerëson se:

- Vendimi 02 Nr. 170/01-15761 për shpalljen e znj. Madeleine Albright "Qytetare Nderi" e Komunës së Glllogocit, i miratuar në Kuvendin e Komunës me datë 29.04.2025, nuk i nënshtrohet shqyrtimit të detyrueshëm të ligjshmërisë.

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal mbetet në dispozicion të Komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejshëm në lidhje me këtë vlerësim.